

UNMIK/RREG/2002/14
15 korrik 2002

RREGULLORE NR. 2002/14

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIKUT NR. 2001/29 MBI DOKUMENTET E
NEVOJSHME PËR NGARJEN E AUTOMJETEVE NË KOSOVË DHE ÇËSHTJE TË TJERA
LIDHUR ME TË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2001/29 mbi Dokumentet e nevojshme për ngarjen e automjeteve në Kosovë dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me qëllim të rregullimit të çështjes së ngarjes së automjeteve në Kosovë dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me anë të kësaj ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/29 duke ndryshuar nenin 5.1 si vijon:

Neni 1
Ndryshimi

Neni 5.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/29 do të jetë si vijon:

5.1 Patentshoferi i lëshuar nga organet kompetente të Republikës Federative të Jugosllavisë në territorin e Kosovës, të cilit i ka skaduar afati pas datës 1 janar 1999 konsiderohet të jetë i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2002. Pas kësaj date, një patentshofer i tillë, përveç nëse është vazhduar siç duhet nga organet kompetente të Republikës Federative të Jugosllavisë jashtë Kosovës ose në pajtim me marrëveshjet e autorizuara qartë nga UNMIKU, do të zëvendësohet me patentshoferin e Kosovës me rastin e paraqitjes së kërkesës në organin kompetent qeveritar.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2002.

Michael Steiner,

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm